

TLAS




SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 1 / 2014

NUMRI TOTAL I ÇËSHTJEVE NË VITE Janar 1999 - Dhjetor 2013



Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga



MISIONI I TLAS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) është regjistruar si organizatë jo fitimprurëse, e pavarur, me Vendimin Gjykatë Nr. 346, datë 18/12/2006, themeluar nga CAFOD UK.

TLAS ka filluar aktivitetin si program i Cafod Albania, që në vitin 1999 dhe vazhdon të ofrojë shërbim ligjor falas për kategoritë në nevojë për çështje civile.

Plotësimi i nevojave ligjore të njerëzve në nevojë, sensibilizimi i tyre mbi të drejtat themelore të njeriut, nxitja e ndryshimeve të sistemit ligjor, në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomiko-sociale të individëve dhe grupeve vulnerabël.

OBJEKTIVAT E TLAS

- Të ofrojë shërbime të plota ligjore për shtresat në nevojë të shoqërisë;
- Të sigurojë që njerëzit në nevojë të kenë më shumë akses në sistemin ligjor;
- Të ndërmarrë inisiativa për përmirësime në legjislacion, advokim dhe lobbying për realizimin e tyre;
- Të ndikojë në përmirësimin e qeverisjes, përmes përfshirjes së grupeve vulnerabël;
- Të botojë të dhëna mbi probleme të rëndësishme ligjore dhe të të drejtave të njeriut, që janë ndeshur gjatë trajtimit të rasteve të klientëve të TLAS.

BORDI DREJTUES

Vangjel Kosta
Viktor Gumi
Dashamir Kore
Elton Lula
Shkelqim Bozgo

ADRESA & KONTAKTE:

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)
Bulevardi "Bajram Curri"
Pallatet Agimi, shk. 18, ap. 322, Tiranë - Shqipëri
Tel/Fax: +355 4 2258 442
Tel: +355 4 2253 114
Kutia Postare 69
E-mail: tlas@tlas.org.al
www.tlas.org.al

Të dashur përfitues, donatorë dhe partnerë të TLAS,

Më lejoni t'ju prezantoj disa nga aktivitetet e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, TLAS gjatë vitit 2013.

Edhe këtë vit aktivitetet e TLAS kanë patur si pikënisje prioritetet strategjike të parashikuara në planin afat-mesëm 2010-2013. Gjatë vitit 2013, TLAS vazhdoi të përqëndrohet në informimin dhe këshillimin ligjor të grupeve në nevojë, si dhe në përfaqësimin e tyre në gjykatë e administratë; vazhdoi aktivitetet ndërgjegjëse në komunitet përmes "street law" dhe shërbimeve "mobile"; vazhdoi punën e nisur për ngritjen e kapaciteteve përmes ëorkshopeve e trainimeve të organizatave me bazë komunitare dhe të punonjësve të administratës shtetërore që ofrojnë shërbime për njerëzit në nevojë; vazhdoi punën me nisma të reja për përmirësime ligjore në favor të interesave të grupeve vulnerabël si dhe fushatat advokuese dhe lobuese për miratimin e tyre.

Ndër të tjera ekspertët dhe stafi i TLAS realizoi gjatë vitit 2013 "Studimin dhe vlerësimin e situatës për mundësimin e regjistrimit elektronik të të porsalindurve në Shqipëri". Përmes një pune këmbëngulëse që mbuloi gjithë territorin e Shqipërisë u arrit: Hartëzimi i vendndodhjes së Zyrave të Gjendjes Civile, të Materniteteve dhe Shtëpive të Lindjes kudo në territorin e vendit; Vlerësimi i situatës aktuale të Materniteteve dhe Shtëpive të Lindjes dhe nevojat e tyre;



Kushtet teknike për kompjuterizimin e sistemit të regjistrimit të lindjeve dhe instalimin e programit elektronik ndërmjetë një-sive të lindjes dhe gjëndjes civile; Vlerësimi financiar për realizimin e këtij sistemi të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtavë e të fëmijëve.

Përmes këtij raportimi shpresoj të kemi dhënë për lexuesit e interesuar një informacion të dobishëm mbi punën dhe performancën e TLAS, mbi metodologjinë e përdorur nga stafi, studentët, vullnetarët dhe

partnerët, mbi të dhënat statistikore dhe disa histori të vërteta përfaqësuese të grup klientëve tanë.

Përfitoj nga rasti të falenderojë donatorët tanë si UNICEF Ddhe Agjensinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, CRD, Fondacionin Vodafone Albania, përfituesit nga projektet e TLAS, si dhe partnerët tanë të shumtë,

Sinqerisht,

Raimonda BOZO
Drejtore Ekzekutive e TLAS



Përmbledhje e Studimit për vlerësimin e situatës dhe mundësimin e regjistrimit elektronik të të porsalindurve në Shqipëri

Regjistrimi i Lindjes është shumë i rëndësishëm për ekzistencën e fëmijës dhe vëndin që ai duhet të ketë kudo që jeton. Në momentin që një fëmijë lind, gjithë e ardhmja e tij mund të varet nga një copë letër që ne e quajmë Certifikata e Lindjes. Pa atë dokument, fëmija rrezikon të humb gjithshka, aksesin në të drejtat themelore ligjore, politike, sociale, shëndetësore, arsimore që i takojnë në bazë të ligjit. Pa atë dokument të rëndësishëm, jeta e fëmijës është e kërcënuar dhe ai apo ajo janë më shumë vulnerabël ndaj abuzimit, trafikimit apo shfrytëzimit.

Në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, artikulli 7, theksohet: "Fëmija duhet të

regjistrohet menjëherë mbas momentit të lindjes, duhet të ketë të drejtën e emrit, të drejtën e shtetësisë, të drejtën e kujdesit nga prindërit"

Aktualisht, momenti që shënon hedhjen në letër të të dhënave baze për një të porsalindur për regjistrimin në gjendjen civile e ka filluesin në institucionet shëndetësore ku ndodh lindja. Personi i autorizuar plotëson formatin e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe ajo "copë letër" quhet Certifikata e Asistencës në Lindje. Kjo Certifikatë e asistencës në lindje dorëzohet



nga prindërit e fëmijës në zyrën e gjendjes civile ku finalizohet regjistrimi i lindjes së fëmijës dhe dokumenti i lëshuar nga kjo zyre është dokument i rëndësishëm për të cilin shprehet Konventa e Kombeve të Bashkuara dhe që quhet Certifikata e Lindjes.

Sot në Shqipëri është përgjegjësia e prindit të marri Certifikatën e asistencës në lindje nga materniteti apo shtëpia e lindjes dhe të paraqitet në Gjendjen civile.

- Nëse prindi nuk paraqitet për një apo disa arsye, fëmija nuk regjistrohet pa ju nënshtruar verifikimit të faktit bazuar në dokumenta të kërkuara nga ligji.

- Nëse nëna jep në maternitet të dhëna të pasakta fëmija nuk regjistrohet.

- Nëse personi i autorizuar në institucionin shëndetësor nuk e plotëson me korrektesë Certifikatën e Asistencës në lindje, lidhur me të dhënat personale të nënës fëmija nuk regjistrohet.

- Nëse nëna që lind jashtë institucionit shëndetësor nuk siguron raportin mjekësor nga personeli i autorizuar në këtë rast, fëmija nuk regjistrohet.

Studimi i fizibilitetit të vlerësimit të situatës aktuale të regjistrimit të lindjeve dhe elektronizimit të këtij sistemi synon që të institucionalizojë përgjegjësinë për regjistrimin e fëmijës në Shqipëri përmes regjistrimit automatik nga Institucioni i Lindjes në gjendjen civile, pavarësisht nga prindi. Raportimi i lindjes në kohë reale nga institucioni shëndetësor në departamentin e gjendjes civile do të evitojë gjithë ato parregullsi të evidentuara deri tani dhe do të mbrojë interesin më të lartë të fëmijës.





Hartëzimi i Zyrave të Gjendjes Civile, i Materniteteve dhe Shtepive të lindjes në Shqipëri



Maternitet



Shtepia e lindjes



Bashkia



Zyra e Gjendjes Civile

Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i këtij studimi është përmirësimi dhe plotësimi i Regjistrimit dhe Sistemi i Raportimit të Lindjes së Fëmijëve në Shqipëri si dhe kontributi për të udhëzuar strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Brendshme si dhe aktorët e tjetër të interesuar për një mënyrë efektive të regjistrimit të fëmijëve përfshirë regjistrimin dhe raportimin e tyre në mënyrë elektronike nga institucionet shëndetësore tek zyrat e gjendjes civile.



Analiza fokusohet në sistemin aktual të funksionimit të strukturave shtetërore si shërbimeve të regjistrimit në zyrat e gjendjes civile dhe institucioneve shëndetësore (maternitetet dhe qendrat shëndetësore) që funksionojnë në vend si dhe për lindjet që ndodhin jashtë institucioneve shëndetësore.

Raporti është ndarë në pesë pjesë, përvec hyrjes dhe përmbledhjes ekzekutive. Pjesa e parë paraqet shtrirjen gjeografike GIS të të gjithë sistemit të zyrave të gjendjes civile, materniteteve dhe qendrave shëndetësore në Shqipëri; pjesa e dytë paraqet metodologjinë e përdorur nga grupet e punës në terren për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit; pjesa e tretë paraqet një përshkrim të teknologjisë ekzistuese; pjesa e katërt një përshkrim dhe analizë të kostove për kompjuterizimin e materniteteve dhe qendrave shëndetësore; pjesa e pestë përmban shtojcat me të dhënat, grafikët, fotografi dhe raste studimore për lindjen që

ndodhin jashtë qendrave shëndetësore.

Metodologjia e përdorur për këtë vlerësim përfshin informacione të ndryshme të bazuara në teknika të ndryshme kërkimore, sasiore dhe cilësore. Është kryer rishikimi i informacionit dhe si dhe diskutime të gjera pas çdo misioni si vazhdim i punës së përditshme në terren dhe aktiviteteve kyesore për mbledhjen e të dhënave në 37 maternitete, 75 qendra shëndetësore dhe 355 zyra të gjendjes civile. Informacioni është mbledhur nëpërmjet vizitave të drejtpërdrejta në maternitete, qendra shëndetësore, intervista, pyetësorë, vëshgime, diskutime me grupet e punës dhe fotografive gjeografike të marra drejtpërdrejt në terren.

Disa rezultate:

Rezultatet e përfituara nga ky studim dhe puna në terren do të jenë të dobishme për të gjithë aktorët përgjegjes në regjistrimin e lindjes së fëmijëve

dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për politikë bërësit, ekspertët e agjencive kombëtare dhe ndërkombetare, zyrtarët shtetërorë dhe organet legislative.

Në analizën makro të gjetjeve të këtij raporti, shtrirjen gjeografike dhe analizave të bërë gjatë këtij studimi rezulton se ligjet ekzistuese, rregullat, strukturat dhe shërbimet për procesin e regjistrimit të lindjeve nuk po arrijnë rezultatet e kërkuara.

Mekanizmat e koordinimit në nivelin qendror ndërmjet Minis-





trisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë nuk planifikojnë bashkëpunimin dhe zhvillimin e një sistemi të integruar për regjistrimin e lindjeve; nuk ka marrëveshje bashkëpunimi operacionale ndërmjet tyre të cilat të kenë në fokus aspektet procedurale të parashikuara në Ligjin për Gjendjen Civile.

Në nivelin lokal, koordinimi ndërmjet drejtuesve të komunitetit, nëpunësve që i shërbejnë drejtpërdrejt komunitetit si nëpunësit e zyrave të gjendjes civile, mamitë apo infermieret si dhe punonjësit sociale duhet të jetë më i ngushtë në procesin e iden-

tifikimit, regjistrimit dhe raportimit të lindjeve ose për referimin e problemeve tek strukturat e nivelit kombëtar për kategoritë e ndryshme të çështjeve të fëmijëve të paregjistruar.

Të dhënat sasiore dhe cilësore të mbledhura nga studimi janë një udhëzues për përmirësimet e mëtejshme të sistemit të regjistrimit dhe raportimit të lindjeve në qendrat shëndetësore, të cilat do të trajtojnë problematikën në të gjithë vendin.

Gjetjet kryesore nga studimi mund të klasifikohen në dy grupe:

Gjetjet kryesore në lidhje me mënyrën e përdorimit të dokumentimit dhe metodologjisë për të regjistruar e raportuar për nënat dhe të porsalindurit në njësitë shëndetësore objekt studimi.

Gjatë viti 2012 në Shqipëri pati një numër lindjesh prej 35,012 fëmijësh; 34,795 prej tyre kanë lindur në 37 maternitete dhe

vetëm **217 fëmijë kanë lindur në 23 qendra shëndetësore.**

Bazuar në analizën e intervistave, vizitave dhe pyetësorëve, në **52 qendra shëndetësore**, pjesë e sistemit shëndetësor në komuna, **nuk pati asnjë rast lindjeje gjatë vitit 2012 dhe gjatë viteve paraardhëse.**

Në 100% të raste, personat e autorizuar në maternitetet dhe qendrat shëndetësore të përzgjedhur për të pajisur nënat me dokumentet shkresore për lindjen e një fëmije, **i regjistrojnë të dhënat në mënyrë manuale për të plotësuar Certifikatën e Asistencës në Lindje.**

Vetëm 72% e stafit të autorizuar në maternitetet dhe qendrat shëndetësore po përdor Certifikatën e rifreskuar të Asistencës në Lindje **dhe 28% e tyre po përdor ende, versionin e vjetër të Certifikatës së Asistencës në Lindje.**

62% e të intervistuarve në 112 njësi shëndetësore dhanë përgjigjet dhe arsyet e tyre, përse disa lindje ndodhin jashtë institucioneve shëndetësore 81.3% e njësive shëndetësore

përdorin dokumente pranimi për nënat që shkojnë për të lindur fëmijët e tyre. 98% e nënave paraqesin letërnjoftimin për regjistrimin në maternitet apo qendrat shëndetësore.

88.4% e njësive shëndetësore raportojnë të dhënat për të porzalindurin vetëm tek strukturat shëndetësore sic parashikohet në rregulloret e brendshme të Ministrisë së Shëndetësisë dhe **vetëm 11,6% e tyre shprehen se raportojnë lindjet drejtpërdrejt, dhe në zyrat e gjendjes civile.**



Gjetjet kryesore për përdorimin e teknologjisë në maternitete dhe qendra shëndetësore

Në 56% të 112 strukturave shëndetësore të intervistuar ka kompjutera. Por, zakonisht kompjuterat përdoren nga stafi i Administratës dhe ai i Financës. Stafi i autorizuar për të lëshuar Certifikatën e Asistencës në Lindje, si mjekët, mamitë, infermieret ose kryeinfermieret nuk kanë akses në kompjutera.

- 80% e strukturave shëndetësore të intervistuar duhet të

trainoheshin për përdorimin e kompjuterave dhe vecanërisht për programe të tilla si Excel apo programe të ngjashme.

- 100% e të intervistuarve përdornin komunikimet e lëvizshme.
- 56% nga 112 struktura shëndetësore të intervistuar kanë akses në internet në institucionet e tyre dhe afërsisht 71.4% e strukturave shëndetësore i përfitojnë kostot për aksesin në internet nga buxheti i shtetit.
- 86% e materniteteve kanë burime alternative për të siguruar energjinë elektrike, nëpërmjet gjeneratorëve.



Probleme për Diskutim:

Gjetjet e radhitura më lart dhe opinionet e tjera të marra kanë qenë objekt diskutimi me grupin e ekspertëve për të konkluduar mbi çështje të rëndësishme si:

- Si, kur dhe ku duhet të raportohen;
- Cilësia e dokumentacionit të lindjes në lidhje me saktësinë e të dhënave të grumbulluara dhe regjistrimet e mbajtura në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë;
- Mospërcjellja e informacionit dhe mungesa e statistikave të raportuara tek zyrat e gjendjes civile për të parandaluar fenomenin e mosregjistrimit të lindjeve.
- A kanë të gjitha 75 qendrat shëndetësore aktivitet lindjesh të të porsalindurve?

Nga të dhënat e mbledhuara del qartë që në nivelin sektorial institucional, psh në strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë ekzistojnë përgjegjësi të qarta për regjistrimin e të dhënave

të lindjeve të fëmijëve, e njëjta gjë edhe në nivelin sektorial brenda për brenda Ministrisë së Brendshme, por nuk ekzistojnë përgjegjësi të qarta për koordinimin e veprimeve dhe raportimeve në nivelin ndërsektorial nga Ministria e Shëndetësisë tek Ministria e Brendshme dhe anasjelltas. Ky fakt dikton nevojën e krijimit të mekanizmave koordinues efektivë. Mungon një mekanizëm koordinimi në nivel qendror ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Brendshme; për rrjedhojë nuk ekziston një vizion i integruar ose një plan ndërsektorial për hartimin e marrëveshjeve operacionale për monitorimin e duhur të sistemit të regjistrimit të lindjeve.

Punonjësit, të cilët i shërbejnë drejtpërdrejt komunitetit si infermieret, mamitë, mjekët dhe drejtuesit e komunitetit identifikojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndërsektorial për të përmirësuar sistemin e regjistrimit të lindjeve. Ata pohojnë se, tashmë, është fakt lindja e fëmijëve jashtë strukturave shëndetësore. Këto

lindje nuk regjistrohen rregullisht, nuk ka statistika të sakta dhe nuk raportohen në mënyrë të saktë tek strukturat shëndetësore ose zyrat e gjendjes civile.

Përsa i përket kuadrit ligjor dhe politikave të viteve të fundit, Shqipëria ka bërë përparime të dukshme, me miratimin e ndryshimeve të reja për përmirësimin e procesit të regjistrimit të fëmijëve. Shpesh, këto rregullime institucionale ose strukturale nuk njihen mirë nga punonjësit e tyre, vecanërisht të strukturave shëndetësore. Staf i materniteteve dhe qendrave shëndetësore nuk ka njohuritë dhe informacionin e duhur për ndryshimet ligjore. Ato, gjithashtu, kanë mungesë informacioni për rrjedhën e informimit nga strukturat shëndetësore tek zyrat e gjendjes civile për të parandaluar sa më shumë që të jetë e mundur fenomenin e lindjeve të paregjistruara.

Nga analiza e të dhënave në kuadrin e këtij studimi fizibiliteti rezultoi se një pjesë e legjislacionit të rishikuar nga Qeveria

Shqiptare në lidhje me përmirësimin e procesit të regjistrimit të lindjeve duhet të përdoret për të ngritur kapacitetet e punonjësve që japin shërbimin e drejtpërdrejtë ndaj komunitetit në maternitetet dhe qendrat shëndetësore, përfshirë drejtuesit e komunitetit dhe punonjësit socialë.

Një cështje tjetër që rezultoi nga studimi në lidhje me lindjet e ndodhura jashtë qendrave shëndetësore ishte sugjerimi për rolin e rëndësishëm që mund të luajnë punonjësit socialë në kushtet e mungesës së punonjësve të strukturave shëndetësore. Në këto raste mungesa e tyre, nuk mund të jetë më kufizim (lutem shih, rastin studimor nr. 1 në Shtojcën 1 të këtij raporti). Aktualisht punonjësit social mund të ngarkohen me përgjegjësinë e identifikimit, referimit dhe asistencës në dhënien e provave të nevojshme për përfundimin e procedurave të regjistrimit të lindjeve sic parashikohet në legjislacionin e gjendjes civile.

Intervistat dhe pyetësorët në këtë drejtim përfshijnë prova për përfaqësuesit e autorizuar të qendrave shëndetësore dhe përdoruesve të tyre për plotësimin e Certifikatave të Asistencës në Lindje dhe pajisjen e nënave me to. **Në shumë pak qendra shëndetësore (11% nga 112) punonjësit e shëndetësisë të intervistuar deklaruan që ata i kanë dërguar raportet e lindjeve në regjistrat e gjendjeve civile.** Është e qartë që shumica e materniteteve dhe qendrave shëndetësore nuk e kanë në përshkrimin e punës së tyre raportimin e lindjeve në zyrat e gjendjes civile, përsa i përket rregullshmërisë së tyre dhe kujt duhet ti raportojnë.

Konkluzione:

Në mënyrë që Sistemi Elektronik i Regjistrimit të Lindjeve të funksionojë si zgjidhje përfundimtare për të gjithë sistemin e regjistrimit të lindjeve në Shqipëri duhet:

- Të hartohen plane dhe marrëveshje të përbashkëta pune në nivelin institucional ndërmjet Ministrive përkatëse dhe strukturave të tjera.
- Të ulet ndjeshëm afati i gjithë procesit të regjistrimit të lindjeve, përfshirë edhe regjistrimin në regjistrin themeltar;
- Të minimizohen gabimet në regjistrimin e të dhënave personale të nënës duke përdorur numrin e identifikimit sipas regjistrit kombëtar.
- Gjithashtu, të ndërmerren iniciative për regjistrimin e fëmijëve vulnerabël dhe të përjashtuar, si për shembull fëmijët që jetojnë në vendbanimet e komunitet rom, fëmijët e braktisur, etj.
- Të koordinohen në mënyrë specifike përpjekjet për regjistrimin e fëmijëve që kanë lindur jashtë institucioneve shëndetësore;
- Të përmirësohen kushtet e jetesës të fëmijëve dhe të përmirësohet rivendosja e të drejtave të tyre.

Rekomandime:

Krijimi i sistemit elektronik të regjistrimit të të dhënave për lindjen e fëmijëve dhe raportimi i tyre është një trajtim efektiv jo vetëm për identifikimin e lindjeve të paregjistruara por edhe për rritjen e efikasitetit të sistemit shëndetësor të raportimit, duke prodhuar raporte periodike për monitorimin e shëndetit të fëmijës.

Nevoja për të promovuar përdorimin e teknologjisë së informacionit si mjet për konsolidimin e regjistrimit dhe raportimit të lindjeve në kohë reale duhet

të theksohet dhe të shtohet si përgjegjësi e funksionarëve të sistemit shëndetësor. Kjo përgjegjësi kërkon garancinë që të dhënat e mbledhura në nivel lokal në maternitete dhe qendra shëndetësore, të përcillen tek Niveli Kombëtar i Shëndetit dhe Niveli Kombëtar i Gjendjes Civile dhe anasjelltas, për të garantuar qartësi në rolet, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, si dhe për të trajtuar praktikatat pozitive dhe negative të sistemit të regjistrimit të lindjeve për të gjithë përdoruesit. Trainimi i specialistëve të sistemit shëndetësor si infermieret, mamitë, mjekët e specializuar, nëpunësit e statistikave dhe stafit tjetër që trajton regjistrimin e të dhënave duhet të konsiderohet si prioritet dhe duhet suportuar me materiale të tjera ndërgjegjësuuese si postera, fletëpalosje, udhëzues për individë të ndryshëm si dhe media. Hapa duhet të ndërmerren për të aftësuar më shumë drejtuesit e komunitetit, ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe lidhjen e tyre me rrjetin e zyrave të gjen-



djeve civile, punonjësve social, punonjësve të sistemit të shëndetësisë (infermieret, mamitë, mjekët), dhe organizatave të tjera jo qeveritare komunitare për të lehtësuar regjistrimin e lindjeve në strukturat shëndetësore dhe dërgimin e nënave më vulnerabël në vendet e duhura për të kërkuar ndihmë. Trainimet do të shërbejnë, edhe, për të shkëmbyer eksperiencat e deritanishme dhe ato inovative, praktikat e mira dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal.


Një nga rekomandimet është administrimi më i mirë i të dhënave nga burimet e ndryshme (Jo vetëm nga institucionet shëndetësore). Vecanërisht, në zonat ku punonjësit e sistemit shëndetësor nuk janë të pranishëm gjatë lindjes së fëmijës, sistemi i shërbimit social duhet të luajë rolin e tij dhe duhet të jetë aktori më i interesuar dhe kompetent për asistencën dhe raportimin.



Gjatë vitit 2013, numri akumulativ i klientëve të shërbyer nga TLAS që nga 1999 arriti 16863. Vetëm gjatë vitit 2013, janë trajtuar 922 çështje nga të cilat 522 me rrugë administrative dhe 400 me rrugë gjyqësore. Gjithashtu, janë këshilluar dhe shërbyer për mes linjës telefonike 583 qytetarë.


NUMRI I ÇESHTJEVE SIPAS GRUPEVE TE SYNUARA

Janar 2013 - Dhjetor 2013



NUMRI I ÇESHTJEVE SIPAS LLOJIT

Janar 2013 - Dhjetor 2013



Informimi dhe ndërgjegjësimi i më shumë se 6,700 individëve në nevojë nga Tirana dhe rrethet e tjera të Shqipërisë për të drejtat ligjore dhe sociale dhe për të drejtën e aksesit në drejtësi.

i) Aktivitetet e “Street law”

Në vijim të shërbimeve ligjore në zyrë, TLAS ka vazhduar implementimin e suksesshëm të aktiviteteve të “Street law” për shpërndarjen e botimeve, për publikimin e informacioneve të thjeshta ligjore e komunikimin direkt me përfituesit. Numri i studentëve vullnetarë nga Fakultetet e Drejtësisë dhe Punës Sociale, pjesë e programit të intership në TLAS ka ardhur duke u rritur.



Gjatë Vitit 2013 janë zhvilluar aktivitetet e STREET LAW si më poshtë:

Për projektin e financiar nga CRD (Civil Rights Defenders) për vitin 2013

	Data	Vendi	Nr.total i përfitueseve	Nr.total i publikimeve
1	04.02.2013	Tirane	50 përfitues	200 publikime, fletëpalosje e broshura
2	15.03.2013	Fier	70 përfitues	280 publikime, fletëpalosje e broshura
3	01.04.2013	Durres	30 përfitues	150 publikime, fletëpalosje e broshura
4	07.05.2013	Elbasan	60 përfitues	240 publikime, fletëpalosje e broshura
5	12.06.2013	Tirane	50 përfitues	240 publikime, fletëpalosje e broshura
6	05.07.2013	Tirane, Kruje	50 përfitues	240 publikime, fletëpalosje e broshura
7	12.09.2013	Fier (Lushnje)	60 përfitues	260 publikime fletëpalosje e broshura
8	20.09.2013	Tirane	50 përfitues	230 publikime, fletëpalosje e broshura
9	08.10.2013	Elbasan	30 përfitues	170 publikime, fletëpalosje e broshura
10	11.11.13	Durres	50 përfitues	210 publikime, fletëpalosje e broshura
11	10.12.2013	Fier	50 përfitues	240 publikime, fletëpalosje e broshura
12	10.01.2013	Elbasan	30 përfitues	170 publikime, fletëpalosje e broshura


Për projektin e financuar nga UNICEF për vitin 2013

	Data	Vendi	Nr.total i perfitueseve	Nr.total i publikimeve
1	18.07.2013	Tirane	70 përfitues	250 publikime, fletëpalosje dhe broshura
2	05.09.2013	Durres	50 përfitues	200 publikime, fletëpalosje dhe broshura
3	18.09.2013	Elbasan	50 përfitues	250 publikime, fletëpalosje dhe broshura
4	10.10.2013	Berat	50 përfitues	200 publikime, fletëpalosje dhe broshura
5	05.11.2013	Fier	100 përfitues	250 publikime, fletëpalosje dhe broshura
6	13.12.2012	Tirane , Kruje	100 përfitues	200 publikime, fletëpalosje dhe broshura
7	18.07.2013	Tirane	70 përfitues	250 publikime, fletëpalosje dhe broshura
8	20.03.2013	Divjake, Mize	100 përfitues	200 publikime, fletëpalosje dhe broshura
9	15.04.2013	Kavaje, Peqin	80 përfitues	160 publikime, fletëpalosje dhe broshura
10	19.04.2013	Lushnje	70 përfitues	250 publikime, fletëpalosje dhe broshura
11	26. 4.2013	Kucov, Skrapar	60 përfitues	150 publikime, fletëpalosje dhe broshura
12	05.09.2013	Durres	50 përfitues	150 publikime, fletëpalosje dhe broshura

Për projektin e financuar nga Fondacioni Vodafone Albania për vitin 2013

	Data	Vendi	Nr.total i perfitueseve	Nr.total i publikimeve
1	23.09.2013		60 përfitues	150 publikime
2	12.10.2013		60 përfitues	150 publikime
3	10.11.2013		60 përfitues	150 publikime
4	14.12.2013		60 përfitues	150 publikime





Vizitat në komunitet janë takime informale dhe kanë si objekt bisedat e stafit të TLAS me persona të komunitetit, takimin me persona në rrugë dhe në vende ku mbledhen njerëzit, shpërndarjen e informacionit si fletëpalosje dhe broshura, etj. si dhe identifikimin e problemet e individëve të cilët kanë nevojë për ndihmë ligjore.

Takimet në Komunitet janë takime më formale dhe synojnë organizimin e takimeve ku ftohen zyrtarë të pushtetit vendor dhe përfitues të shërbimeve të TLAS. Në vijim të ofrimit të shërbimeve ligjore për çështjet, takimet ndihmojnë TLAS për të vlerësuar problemet e vecanta

të komunitetit dhe nevojat e tyre si dhe marrin mendimin e komunitetit për aktivitetet e zhvilluara të street law.

Shpesh prioritetet e shërbimeve të TLAS bazohen në probleme të identifikuara gjatë takimeve të street laë. Këto takime ndikojnë ndjeshëm për përsosjen e metodologjisë së punës të stafit të TLAS duke përfshirë dhe shërbimin "mobile" në veçanti. Gjatë aktiviteteve të street laë automjeti i TLAS pajiset si "shërbim ligjor mobile" me të gjitha mjetet e nevojshme (laptop, printer, etj) për t'i dhënë mundësi përfituesve të marrin direkt në terren ndihmën e parë ligjore nga stafi.

III - Seminare informuese dhe trainuese me punonjësit e njësive të institucioneve shëndetësore dhe ata të mbrojtjes së fëmijëve



Durrës, 11 Dhjetor 2013
Donator: UNICEF
Pjesëmarrës 24 punonjës



Berat, 12 Dhjetor 2013.
Donator: UNICEF
Pjesëmarrës 31 punonjës



Tirane, 13 Dhjetor 2013
Donator: UNICEF
Pjesëmarrës 30 punonjës



Fier, 18 Dhjetor 2013
Donator: UNICEF
Pjesëmarrës 30 punonjës



Elbasan, 19 Dhjetor 2013
Donator: UNICEF
Pjesëmarrës 36 punonjës



Elbasan, 20 Dhjetor 2013
Donator: UNICEF
Pjesëmarrës 20 punonjës

TLAS organizoi seminare trainuese me gjyqtarët, avokatët dhe organizatat me bazë komunitare:



Korçë, 24. 10. 2013
Donator: CRD
Pjesëmarrës 30 persona



Kukës, 25. 10. 2013
Donator: CRD
Pjesëmarrës 38 persona



Tiranë, 21.09.2013, ëorkshop me
anëtarët e Shoqatës për Mbro-
jtjen e punës dhe të Demokra-
cisë
Donator: CRD
Pjesëmarrës: 25 persona



**Tiranë, 30.12.2013, workshop
me anëtarët e organizatës
Rome, Zemra e Nënës
Donator: CRD
Pjesëmarrës: 30 persona**



**Tiranë, 26.02.2013
Tryezë e Rrumbullaket me temë
“Përmirësimi i Sistemit të Ndhmës
Juridike në Shqipëri”.
Donator: CRD Civil Rights Defenders)
Me mbështetjen e e Avokatit të Po-
pullit, EURALIUS, Dhomës Kombëtare
të Avokatisë
Pjesëmarrës 36 persona**



**Tiranë, 21.06.2013
Tryezë e Rrumbullaket për
gjetje dhe rekomandime në
lidhje me sistemin elektronik
të regjistrimeve të lindjeve në
Shqipëri,
Donator: UNICEF.
Pjesëmarrës 39 persona**

Histori e Vërtetë

Rasti i Klientes L.P.

Përmbledhje: Vajza 5 vjeçe qe injeksioni ne vend qe t'i ulte temperaturën e larte i paralizoi këmbën e djathtë. Kush përgjigjet për dëmtimin e shëndetit të vajzës, pse pandëshkueshmëria për mungesën e profesionalizmit vazhdon të jete prezent në jetët e njerëzve sidomos të atyre nga grupet vulnerabël?

Rasti qe po përshkruajmë është strategjik sepse prapa tij qëndron një numër i madh rastesh të tjera qe qytetarët hasin në fush-

ën e shëndetit, por që nuk kanë mundësi t'i ndjekin apo të përballojnë procedurat administrative dhe gjyqësore

Nena dhe gjyshja e fëmijës L.P u paraqiten në zyrat e TLAS me një ngarkese shpirtërore të dukshme dhe shumë shprehëse. Ato filluan te tregonin te dyja bashkë se vajza e vogël L.P, ne prehrin e nënës , e moshës 5 vjeçe, për shkak të një temperature shumë të lartë, u shtrua në repartin e urgjencës në Qendrën Spitalore Universitare “ Nënë Tereza” Tiranë, e shoqëruar nga gjyshja e saj.

Mjeku i urgjencës pasi kishte vizituar vajzën e vogël, duke parë gjendjen e saj të rëndë shëndetësore, ka vendosur trajtimin e saj me antipiretik paranteral (Paracetamol intramuskular, injeksion) si dhe perfusion, (serum) për përmirësimin e gjendjes së saj klinike. Infermierja e turnit zbatoi rekomandimet e mjekut.

Sapo u bë injeksioni nga infermierja, fëmija L.P, ka reaguar menjëherë, duke qarë deri në nxirje,



ndërsa këmba e majtë i ka ngelur e ngrirë. Pas kësaj infermierja ka thirrur menjëherë mjekun që kishte bërë rekomandimin. Ky i fundit e ka vizituar L.P dhe ka konstatuar se këmba ku ishte bërë injeksioni kishte humbur ndjeshmërinë. Në ditët në vazhdim fëmija L.P ka qëndruar në spital, me qëllim rikuperimi të këtij deficiti neurologjik i cili sillte si pasojë probleme në lëvizje te gjymtyrës dhe në ecje. Pas qëndroi e shtuar në spital prej 10 ditësh, pacienten e kanë nxjerrë nga pavioni me rekomandimin për në KEMP.

Prandaj A.S, nëna e fëmijës u paraqit në zyrën tonë pasi kishte filluar procedimin penal dhe duke qenë e pafuqishme të ndiqte vet çështje shtroi kërkesën për asistencë ligjore në vazhdim të procesit. Kështu filloi puna me këtë rast tipik pandëshkueshmërie nga avokatët e TLAS.

Avokati i TLAS ndoqi procesin penal, dhe me përfundimin e tij u arrit konkluzioni se infermierja e turnit shpallet fajtores për veprën penale të "Mjekimit të pakujdesshëm",



dhe është dënua me gjobë , ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Pas këtij momenti TLAS filloi procedurat e kërimit të shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor nga institucioni spitalor tashmë në një proces gjyqësor civil. Çështja kërkonte një punë studimore te bazës ligjore të kujdesshme, me këmbëngulje e pasion për hartimin sa më të bazuar të kërkesëpadisë civile dhe mbledhjen e provave.

Në kërkimet parashtruar gjykatës u argumentua se paditësja ka pësuar një dëm të parikuperueshëm



në shëndet. Gjithashtu nga vendimet penale të arsyetuara është e vërtetuar lidhja shkakësore mes veprimit dhe pasojës së ardhur në shëndetin e fëmijës nga infermierja e institucionit spitalor. Paraliza e menjëhershme e këmbës së vajzës ishte rezultat i drejtpërdrejtë i veprimit mekanik, mungesës së profesionalizmit përmes injeksionit të bërë në mënyrën e gabuar nga infermierja.

Avokatja e TLAS në gjykatë kërkoi shpërblimin e Dëmit jopasuror i cili përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore që bëjnë

pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtpërdrejtë ekonomik në treg. Dëmtimi i shëndetit është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i paruarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i dëmtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm. Në rastin e klientes L.P, dëmtimi i shëndetit apo dëmi biologjik që ka ardhur si pasojë e faktit të paligjshëm dhe nga e cila lind e drejta e dëmshpërblimit.

Nga ana tjetër çështja u studiua dhe u parashtrua edhe në në kupimin e dëmit moral të shkaktuar si shfaqje traumatike e brendshme, dhe jo vetëm e përkohshme, e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të paditësit dhe të afërmeve të tij, dhimbjet e pallogaritshme në formën e vuajtjeve shpirtërore, gjendjeve të vazhdueshme të ankthit e mundimeve të tjera që rrjedhin si pasojë e këtij fakti të paligjshëm. Dhe cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe

dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Në rastin që po përshkruajmë L.P. dhe të afërmit e saj kanë pësuar një tronditje të thellë, vajza shpesh herë shfaqet e vetmuar në përditshmërinë e saj pasi ndjen dhe vuan dallimin fizik që ka pësuar krahasuar me moshataret, që lëvizin lirshëm të shpenguar dhe të çlirët, siç kishte bërë edhe ajo dikur.

Por edhe dëmi ekzistencial i shkakton nga fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuajse në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkakton përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivisht qënien e tij apo mund ta karakterizojnë pozitivisht

në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm.

Dëmi ekzistencial, duke mos patur natyrë thjesht ndjesore e të brendshme, ishte objektivisht i vërtetueshëm në rastin e klientes L.P., duke qenë e mitur dhe në formim të vazhdueshëm të personalitetit të saj, gjendja e paaftësisë së saj fizike i shkakton vuajtje dhe mundim në procesin e saj të rritjes duke ndikuar në vlerësimin dhe konsiderimin e vetvetes. Ky dëm-



tim i pësuar pengon në mënyrë të vazhdueshme shfaqjen e saj të jashtme si njeri. Veprimtaria e saj e përditshme është tronditur, duke e penguar të shfaqet dhe të ushtrojë e lirshme veprimtaritë normale të moshës së saj, si të luajë, të ecë apo të vrapojë.

Gjatë gjykimit të kësaj çështje avokatja me kërkesën e saj para gjykatës arriti që klientja të përjashtohet nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore si dhe taksës 3% e vlerës së objektit të padisë, e detyrueshme për t'u paguar për çdo çështje të kësaj natyre. Gjykata bazuar në gjendjen shëndetësore të klientes (duke qenë se ajo

tashmë është një person me aftësi të kufizuara) si dhe duke mbajtur në konsideratë gjendjen ekstreme të varfërisë së klientes së mitur dhe familjes së saj, vendosi përjashtimin nga taksa. Kjo ishte një arritje e madhe në këtë çështje pasi ne shume pak raste praktika gjyqësore shqiptare ka lejuar përjashtimin nga taksa me arsyetimin se nuk ka një praktike dhe rregullim specifik ligjor për raste të tilla.

Rasti i klientes L.P pas disa seancave gjyqësore ka përfunduar në favor të klientes L.P. Pasi është kryer dhe një akt ekspertimi, i mbuluar nga fondet e TLAS, nga i cili është vlerësuar dëmi i shkaktuar klientes në vlerë monetare. Gjykata në fund të gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor ka vendosur në favor të klientes sonë. Aktualisht çështja është apeluar nga palët e paditura dhe pritet Gjykimi në Gjykatën e Apelit, gjykatë e cila shpresojmë të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së Rrethit që ka vendosur në favor të klientes.

Kjo çështje është një rast tipik i një litigimi strategjik që ka ndërmarrë



TLAS, i një rëndësie të veçantë, pasi veprimet e paligjshme në fushën e mjekësisë janë të shpeshta, dhe po aq të shpeshta janë edhe rastet e pandëshkueshmërisë profesionale në këtë fushë.

Duke trajtuar rastin e LP, duke luftuar që t'i jepet dëmshpërblimi plotësisht i merituar, jo vetëm kemi mbrojtur të drejtat e një fëmijë të mitur të dëmtuar për shkak të papërgjegjshmërisë së organeve shtetërore, por edhe kemi promovuar një rast precedent në fushën e dhunimit të të drejtave të njeriut. Përmes TLAS, fëmija i dëmtuar pati mundësinë e aksesit në drejtësi, për t'u zhdëmtuar për dëmin e shkaktuar, mundësi të cilën nuk do ta kishte realizuar asnjëherë për shkak të pamundësisë ekonomike, shëndetësore etj.

Po ashtu mendojmë se TLAS ka krijuar një tjetër precedent të rëndësishëm në praktikën gjyqësore sa i takon përjashtimit nga taksa gjyqësore të personave të varfër.

Histori e Vërtetë

Rasti i klientes V.B.

Përmbledhje: Ekzistojnë shumë shkaqe që lidhen me kulturën shqiptare të pandëshkueshmërisë. Disa janë të rrënjosura që në Kushtetutë, siç theksohet në Konceptin e Reformës Kushtetuese të kësaj Strategjie. Të tjerat lidhen me korrupsionin në gjyqësor dhe polici, kuadrin ligjor të mangët dhe të papërditësuar, teknikat e papërshtatshme për të hetuar shkeljet, krimin e organizuar dhe pamjaftueshmërinë e kërkesës së llogarisë nga ana e opinionit publik për





zbatimin e shtetit të së drejtës. TLAS përmes shërbimeve ligjore për individë vulnerabël kërkon të shtyjë sistemin e drejtësisë drejt një niveli më të lartë përgjegjësie, duke marrë përsipër ndjekjen gjyqësore të çështjeve të një profili me interes të lartë publik dhe që mbrojnë të drejtat e njeriut në fusha me rëndësi për qytetarët si shëndeti, aksesit në drejtësi, punësimi dhe siguria. Përhapja e korrupsionit dhe e indiferentizmit apo neglizhimit të qytetarëve influencën kulturën e pandëshkueshmërisë në të gjitha sferat si për punonjësit e shërbimit në strukturat shtetërore ashtu edhe në ata të shërbime-

ve private. Çdo veprim në dobi të luftës së pandëshkueshmërisë është pa diskutim një ndihmesë. Historia e rastit të mëposhtëm është përpjekje tjetër konkrete e TLAS në këtë drejtim.

VB është nëna e dy fëmijëve, dhe FB është me e vogla e tyre. Ajo ka lindur në vitin 2011. Nëna gjatë shtatzanisë ka zgjedhur që të ndiqet për kontrolle nga mjeku me të cilin kishte realizuar ecurinë e shtatzanisë së parë, mjek i punësuar pranë spitalit shtetëror e njëherësh i punësuar pranë një klinike private. Mjeku në fjalë i ka bërë klientes V.B 8 eko gjatë shtatzanisë së saj, nga muaji i 3 (tretë) deri në muajin e 9 (nëntë). Në javën e 23 (njëzetëetretë) të shtatzanisë, klientja ka kryer edhe ekon morfologjike nga e cila vlerësohet me detaje zhvillimi morfologjik i fëmijës.

Edhe pse në atë lloj ekzaminimi (eko morfologjike) pamja dhe qartësia janë shumë të plota për çdo fetus, ky mjek gjithmonë ka konstatuar një pamje dhe zhvillim normal të fëmijës së ankuses. Këtë

normalitet mjeku e ka konstatuar që nga ekoja e pare dhe deri në shtrimin e fundit para lindjes të klientes dhe madje në ekzaminimin 2 orë përpara lindjes ai i ka pohuar që çdo gjë shkonte normalisht. Në momentin e lindjes (e cila ishte lindje normale), u konstatua që fëmija lindi me një anomali fizike, ajo nuk e kishte plotësisht njërin nga gjymtyrët, konkretisht krahun e majtë. Kjo ngjarje passolli një shok të madh tek personeli mjekësor dhe më pas një traumë të pakthyeshme tek klientja dhe familja e saj.

Klientja u paraqit në zyrën e TLAS në fillim të vitit 2013. Gjendja e saj vazhdonte të ishte traumatike. Nga vizita të ndryshme ishte konstatuar që fëmija i saj do ta kishte përgjatë gjithë jetës së saj këtë anomali dhe se ajo ishte e pariparueshme. Trajtimi i fëmijës kërkonte një kujdes të veçantë dhe me ritjen do t'i nevojitej një protezë për ta ndihmuar në kryerjen e veprimeve të përditshme në mungesë të gjymtyrit, përveç traumës dhe punës që do të duhej për ta bërë atë të ambientohej me këtë

anomali që e bënte të ndryshëm nga fëmijët e tjerë. Trajtimi i rasisit paraqiste kërkesa të veçanta për shkak të ndjeshmërisë tepër të lartë të klientes dhe kujdesit që duhej treguar me të në sugjerimin e një ruge ligjore për të rikuperuar sado të ishte e mundur këtë pasojë të ardhur si pasojë e mungesës së kujdesit të duhur profesional nga ana e mjekut të saj. Nga të gjitha vizitat e kryera klientes i ishte thënë që ajo priste një fëmijë me zhvillim normal. Ballafaqimi me këtë situatë në mënyrë të papritur, si pasojë e paaftësisë së mjekut për ta zbuluar dhe për t'ja komunikuar klientes këtë de-



fekt në kohë, kishte sjelle traumën e madhe tek ajo e po ashtu kishte zhdukur çdo mundësi rikuperimi të atij defekti.

Klientja i ishte drejtuar më parë organeve të prokurorisë ku kishte kërkuar që mjeku të ndiqej penalisht, mirëpo kjo çështje ishte pushuar.

Klientja V.B. kërkonte të vinte drejtësi nëpërmjet rastit të saj, duke e konsideruar e përdorur atë në funksion të të mirës së përgjithshme, për të sensibilizuar edhe opinionin por edhe për të dënuar paaftësinë e mjekut, në mënyrë që raste të tilla të minimizoheshin sa më shumë në të ardhmen. Në vendin tone në përgjithësi mungon kultura e përgjegjësisë që një funksionar apo i punësuar shtetëror duhet të mbajë në rast se ai shpërdoron detyrën apo e kryen atë me papërgjegjshmëri.

Konkretisht në rastin në fjalë, mjeku që kishte vizituar klienten vazhdonte të ushtronte detyrën e tij lirisht dhe asnjë masë nuk ishte marrë ndaj tij.

Pas konsultimesh të shumta, në një rrafsh të gjerë ligjor e njerëzor u vendos që ky rast të ndiqej nga TLAS. Hapi e parë ishte raportimi i rastit në Urdhrin e Mjekut, i cili është një institucion që kujdeset për respektimin e rregullave të etikës mjekësore si dhe merr masat përkatëse kur konstatohen gabime mjekësore të kryera nga ana e mjekëve në ushtrimin e profesionit të tyre. Edhe sot nuk është marrë asnjë masë nga Urdhri i Mjekut, për këtë rast i cili nuk është i vetëm në fushën e abuzimit profesional nga armata e punonjësve të shëndetit.

TLAS e hapi rastin në gjykatë duke kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar klientes sonë dhe fëmijës së saj të mitur. Ky rast është në vazhdim për shkak të kompleksitetit të çështjes, të kostos së ekspertizës, dhe do të ndiqet në të gjitha shkallët e gjykimit derisa çështja të zgjidhje në favor të vajzës së gjymtuar dhe nënës së saj të traumatizuar dhe depresuar.

Histori e Vërtetë

Rasti i Klientes S.A.

Përmbledhje: Historia e djalit që për shume se 4 vjet rresht figuron i regjistruar në fletën familjare të një familjeje tjetër. Pse Zyra e gjendjes civile që ka gabuar në regjistrimin e fëmijës nuk e korrigjoi për vite me radhe? Pse administrate dhe struktura hierarkike të gjendjes civile nuk përfillin kërkesat e prindërve për ta korrigjuar gabimin e kryer nga vet ata? Pse sorollatin një nënë dhe një baba që nuk kanë mundësi të venë para përgjegjësisë personat që i kanë shkaktuar këtë gabim me kosto financiare për familje? Pse klientja me iniciale S.A. duhet të shkojë 25 herë në gjendjen civile të Njesisë Administrative nr. 6 dhe të marrë si përgjigje vetëm qëndrimet neglizhente, indiferente, diskriminuese në vend të zgjidhjes së problemit? Pse ky qëndrim ndodh së shumti ndaj familjeve të komunitetit Rom? Qytetarja SA u paraqit para Zyrës së Shërbimit Ligjor Falas, TLAS ne date 25.09.2013, pasi ishte lodhur

dhe rropatur pambarimisht duke kërkuar të drejtën e saj në zyrën e gjendjes civile ku banon. Ajo për herë të parë u ul në një karrige dhe u dëgjua me durim nga një person që me shumë vëmendje mbante shënime, pyeste me kujdes pa dashur ta ndërpriste vend e pa vend. Këto ndjesi i shprehu vet klientja SA në fund të bisedës që në fakt ishte intervistë e detajuar.

SA, bashkëshorti i së cilës ishte FA dhe së bashku kishin katër fëmijë, ka lindur fëmijën e katërt të seksit mashkull në datën 03.08.2009. Fëmija ka lindur në maternitetin "Mbretëresha Geraldinë" në Ti-





ranë te cilin e quajtn Klajdi. Tre jave me vone nga dita e lindjes ne datën 24.08.2009, prindërit e fëmijës paraqiten pranë Zyrës së Gjendjes Civile Paskuqan, me certifikatën e asistencës në lindje dhe me letërnjoftimin elektronik për të bërë regjistrimin e tij. Akti i lindjes mbahet nga punonjësja e gjendjes civile Paskuqan, firmoset dhe vuloet nga vete ajo dhe nga të dy prindërit e fëmijës. Prindërit e fëmijës nuk dinë të lexojnë, janë analfabetë pore dhe punonjësja e gjendjes civile nuk merr mundimin tja u lexojë aktin me kujdes para se prindërit ta firmosin. Prindërit largohen pa kërkuar certifikatë personale për fëmijën.

Çfarë kishte ndodhur më tej? Ne momentin e reflektimit të aktit të lindjes në fletën familjare punonjësja e gjendjes civile në vend ta regjistrojë fëmijën në fletën familjare të babait të tij FA e regjistron Klajdin në fletën familjare të shtetasit FM, shtetas që kishin të njëjtin emër Fredi por jo të njëjtin mbiemër. Deri në momentin që çifti SA dhe FA vendosin të transferohen nga lagja Paskuqan në njësinë nr 6 të kryeqytetit, prindërit nuk e dinin që Klajdi nuk ishte ne certifikatën familjare të familjes së tyre. U gjenden të dy të befasuar kur morën transferimin dhe panë që në vend të katër fëmijëve ata kishin vetëm tre fëmijë.

Kështu filloi odiseja e vajtje ardhjeve nga zyra në zyrë pa mbaruar kurrfarë pune. Sa herë që prindërit paraqiteshin në gjendjen civile të Njesisë nr. 6 dhe kërkonin që fëmija i tyre të kalonte ne fletën familjare të prindërve biologjik, ata përcilleshin në Zyrën e gjendjes Civile të Paskuqanit, dhe anasjelltas ata të Paskuqanit i përcillnin te Njësia Nr. 6 e kështu hidheshin nga njëra njësi në tjetrën sikur të ishin topa futbollit. I kërkonin

dy prindërve të gjorë dokumente të cilat dhe vet ata e dinin që nuk do t'i siguronin kurrë sepse fletët e regjistrimit themeltar ishin nën administrimin e tyre dhe s'kishte arsye që t'ia kërkonin qytetarëve por kishte shumë arsye që t'ia u jepnin me zarf në dorë dhe t'i drejtonin te njësia tjetër. E jo vetëm kaq por duhet të flisnin në telefon me njëra tjetrën në mënyrë që të zgjidhej keqkuptimi që ishte shkaktuar nga vet ata. Pikërisht gabime të tilla rëndojnë veçanërisht te komunitetit Rome, të cilin e shikojnë me mospërfillje, neglizhim dhe diskriminim.

Papërgjegjshmëria e të dy gjendjeve civile në të dy njësitë, dhe kërkesat absurde ndaj njëra tjetrës, vazhduan deri në nëntor 2013, ditën kur prindërit kërkuar ndihmë nga TLAS, të rekomanduar nga organizata Rome "Zemra e Nenës".

TLAS me autorizimin e prindërve filloi mbledhjen e dokumenteve dhe njëkohësisht verifikimin e tyre për të gjetur e vërtetuar gabimin e bërë.

U sigurua një kopje e aktit të lindjes i mbajtur nga punonjësja e zyrë



së gjendjes civile të Paskuqanit, vendbanimit të mëparshëm të çiftit FA dhe SA. U analizua me detaje dhe doli se akti ishte mbajtur me gabime që në fillim sepse deklaruesit e lindjes se Klajdit ishin shënuar që në fillim gabim, në vend të FA ishte FM dhe në vend të SA ishte SM. Që këtu kishte filluar keqkuptimi që bëri Klajdin de jure fëmijën e një familje tjetër. Të qenit analfabetë nuk do të thotë që punonjësi i shërbimit civil të mos ja u lexojë aktin germë për germë të interesuarve. Por duke qenë se prindërit janë të komunitetit Romë askush nuk e vret mendjen të shikojë me vëmendje akte kaq të rëndësishme të jetës së njerëzve

me pasoja për ekzistencën e tyre. U sigurua kopja e fletës së trungut familjar të nënës dhe babait për të parë me detaje pemën familjare të tyre për të vërtetuar që fëmija është dërguar as në njërin as në tjetrën fletë të trungut. Hap pas hapi përjashtohen të gjitha arsyet e gabimit të bërë. Këto dy dokumente ishin shumë të rëndësishëm dhe asnjë nga punonjësit e gjendjes civile nuk i orientonte, as nuk i ndihmonte ti siguronin për të zgjidhur përfundimisht këtë ngërç. Sigurisht dokumentet e martesës dhe të certifikatës së asistencës në lindje janë ishin të domosdoshme për të plotësuar tablonë dhe ekuacionin e të panjohurave. Por të gjitha ato nuk mjaftonin, duhet që babai de jure, FM, të bënte një deklaratë noteriale ku të theksonte që fëmija me emrin Klajdi Ademi, i cili figuron i regjistruar në fletën familjare të tij, nuk është fëmija i tij. Babai de facto, FA duhet të deklaronte para noterit që Kladi ishte fëmija i tij, etj. Të gjitha këto hapa ishin të shoqëruara me kosto financiare edhe me shpenzimin e shume orëve pune, pa llogaritur dëmin

psikologjik që ju ishte shkaktuar dy familjeve nga pakujdesia dhe papërgjegjshmëria e punonjësve të gjendjes civile. Dy familjet Rome për më shumë se 4 vjetë mbajtën në kurriz një problem që u shoqërua edhe me andralla të tjera kur ishte nevoja të aplikonin për ndihmë ekonomike, shëndetësore apo arsimore.

Vetëm me asistimin hap pas hapi të avokatit të TLAS u mblodhën dokumentacionet e nevojshme, u bënë deklaratimet noteriale të kërkuara, dhe në prani të dy kryefamiljareve të lidhur nga kjo ngatërresë u bene korrigjimet respektive, Klajdi Ademi më në fund u regjistrua në fletën familjare të prindërve të tij. Edhe TLAS ju desh një muaj kohë për të zgjidhur një çështje kaq të thjeshtë, që prindërit SA dhe FA nuk mundën ta zgjidhin as për 4 vjet.



Histori e Vërtetë

Rasti i Klientit D.A.

Përmbledhje: Duket e pabesueshme por është më se e vërtetë. D.A është nga komuniteti Rom, banon në Tiranë, është qytetar i Republikës së Shqipërisë, por ai është i padukshëm, pa identitet, pa shtetësi, dhe kjo situatë është mbartur vit pas viti që nga i porsalindur, në fëmijërinë prej 18 vjetësh, rininë dhe u burërua kështu pa një certifikatë lindjeje, pa letërnjoftim, pa numër identiteti, pa pasaportë. Madje ai filloi të bashkëjetojë me një grua dhe bëri edhe tre fëmijë. Lind natyrshëm pyetja pse D.A. nuk e regjistruan në regjistrin e gjendjes civile sapo lindi? Pse prindërit apo të afërmit kushdo qofshin ata që e shikonin çdo ditë të rritej në sytë e tyre nuk e regjistruan qoftë edhe me vonesë? Kur prindërit janë të papërgjegjshëm apo të pafuqishëm për të ndjekur hapat e nevojshme procedurale në bazë të legjislacionit të gjendjes civile, atëherë pse organet shtetërore,

përgjegjëse për interesin më të lartë të fëmijëve, qofshin ato të pushtetit lokal, të gjendjes civile, të arsimit, të shëndetësisë, të policisë nuk treguan interes asnjëherë që për D.A. të fillonin procedurat e regjistrimit të lindjes?

A ka qytetarë të tjerë që nuk mund të regjistrohen dhe nuk mund të kapërcejnë pengesat administrative të nevojshme për t'u plotësuar? Sigurisht që ka, vazhdon të jetë një fenomen veçanërisht për komunitetin Rome, madje vet D.A ka një motër 29 vjeçe të paregjistruar në gjendjen civile, ka edhe një vëlla 34 vjeç po ashtu të paregjistruar në gjendjen civile.



D.A. u paraqit në zyrën e Shërbimit Ligjor Falas, TLAS, i rekomanduar nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Nuk dinte të jepte shumë shpjegime për prindërit, por dinte që nëna jetonte në Rogozhinë, dinte që kishte lindur në maternitetin e Tiranës në vitin 1982, dinte që nëna nuk ishte e martuar me të atin biologjik, dinte që i ati kishte vdekur pa i njohur atësinë. Vetëm këto ishte në gjendje të thoshte D.A.

Konkluzioni kryesor ishte shumë i qartë për TLAS: Regjistrimi i lindjes i D.A. do të kalonte në një sërë procedurash të ndërmjetme para se

të finalizohet akti i lindjes në gjendjen civile, dhe gjithashtu gjithçka do të ndërmerrej dhe asistohet hap pas hapi nga stafi i zyrës sepse ishin të mjaftueshme 32 vjet për të kuptuar që qytetarë si ky mund të qëndronin edhe gjithë jetën i panjohur dhe pa akses në drejtësi apo programe sociale.

Së pari takimi me nënën e D.A's ishte kyçi i zgjidhjes së çështjes sepse në momentin fillestar asnjë nuk dinte ku e kishte lejen e banimit ajo grua.

Nëna u kontaktua direkt në zonën ku banonte dhe bashkëjetonte me një burrë që nuk ishte babai i D.A. Nëna konfirmoi që D.A'n e kishte lindur në maternitetin e Tiranës, te rruga e trenit dhe që kishte dhënë atje emrin e saj dhe mbiemrin e të atit të D.A. me të cilin nuk kishte lidhur kurorë. Kjo sigurisht e dhënë e gabuar do ta komplikonte më tej punën për të shkuar deri te zgjidhja.

Nëna nuk e dinte që martesë zyrtare me bashkëshortin F.B. ishte ende e pazgjidhur, ajo kujtonte se largimi nga bashkëshorti zyrtar ishte njëkohësisht dhe anulim i



martesës, kështu që ajo figuronte me leje banimi në Berat ku edhe figuronte e martuar ligjërisht që më 08.02.1975. Nga kjo martesë nuk kanë pasur fëmijë.

Nëna, ishte larguar nga Berati për në Tiranë në vitin 1978 ku bashkëjetoj me një burrë tjetër, babanë e D.A's dhe lindi njëri pas tjetrit tre fëmijë, të tre të paregjistruar në gjendjen civile.

Kështu TLAS nisi procedurat gjyqësore për zgjidhjen e martesës së nënës së klientit, shtetases GB nga bashkëshorti zyrtar FB. Por para këtij hapi duke qenë se nëna e klientit nuk kishte letërnjoftim elektronik, u shoqërua për në zyrën e gjendjes civile Rajoni nr.2, Berat për të aplikuar për letërnjoftim elektronik dhe për të marrë të gjitha provat e nevojshme për nisjen e procedurave gjyqësore për zgjidhje martesë.

U hartua kërkesë padia dhe u firmos.

U depozitua pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

U hartua dhe u nënshkrua para noterit prokura e lëshuar nga GB



në mënyrë që gjatë seancave gjyqësore GB të përfaqësohej nga avokatet e TLAS.

Por çështja u komplikua në momentin kur GB duhet të paraqitej në Zyrën e gjendjes civile Berat për të nënshkruar aktin e lindjes së D.A. Pikërisht atë ditë ajo në prani të të birit, gjatë udhëtimit nga Rogozhina për në Berat, ndërron jetë në Lushnjë, dhe të birit ju desh të kthehej në Rogozhinë me nënën e tij të vdekur. Kjo ishte vërtet një tragjedi dhe një shans i keq për D.A, i cili priste prej 32 vjetësh të regjistronte identitetin dhe ekzistencën e tij në gjendjen civile.

TLAS u detyrua të zbatonte alternativën tjetër të regjistrimit të lindjes, për rastet kur nëna ka vdekur apo është zhdukur. Pra nisën procedurat e reja nga e para, ato administrative për regjistrimin e D.A. Fillimisht duhet të regjistrohej vdekja e GB dhe pastaj të sigurohej dokumentacioni i nevojshëm:

Certifikata e asistencës në lindje e D.A
Certifikata e vdekjes e GB

Fleta e regjistrimit të gjendjes civile e GB
U njoftua polici i zonës së rajonit 2 Berat

U njoftua punonjësi social/administrativ i rajonit 2 Berat

U kërkuesi i regjistrimit të lindjes që në këtë rast ishte ish bashkëshorti i GB

U përpilua proces verbal i firmosur nga tre persona, kërkuesi, punonjësi social dhe policia, siç u përmendën më sipër, dhe u dorëzua në zyrën e gjendjes civile në bazë të Udhëzimit të Ministrisë së Brendshme D.Atë 07.01.2012.

D.A u regjistrua në gjendjen civile të Rajoni 2 Berat

D.A aplikoi për kartë elektronike për herë të parë në jetën e tij

D.A bëri kërkesë për transferimin e tij nga Berati në Tiranë, si madhor që ka të drejtën të vendosi për lejen e banimit të tij.

D.A bëri martesë zyrtare në Tiranë me gruan që bashkëjetonte.



Dhe përfundimisht D.A. lindi nga e para, mund të quhet bashkëshort dhe baba i tre fëmijëve, si edhe të gëzojë të gjitha të drejtat që i takojnë si qytetar i Republikës së Shqipërisë, të votojë e të zgjedhë, të udhëtojë e të punojë në mënyrë formale, të kërkojë shërbim shëndetësor, të regjistrohet për kurse trajnimi dhe kualifikimi, e shumë të drejta të tjera të munguara e të mohuara deri sot.

Histori e Vërtetë

Rasti i Klientes S.M.

Përmbledhje: Tashmë nuk është më çudi për stafin e TLAS kur dëgjon histori të tilla. Nëna të paregjistruara vet në zyrën e gjendjes civile si rrjedhim fëmijët e tyre të paregjistruar në zyrën e gjendjes civile. Nëna që nuk janë kryefamiljare edhe pse me fëmijë, nëna që nuk mund të martohen ligjërisht me bashkëshortin edhe pse kanë dëshirën për të lidhur martesën, nëna që nuk e dinë ku prindërit e tyre jetojnë, dhe mbi të gjitha që kanë humbur shpresën nëse një ditë lëmshi i problemeve të regjistrimit civil do të zgjidhet dhe hallet e tyre të lidhura me regjistrimin do të mbyllen. Nëna që mendojnë se prindërit e tyre kurrë nuk i kanë kushtuar kohë procedurave të regjistrimit, kurrë nuk e kanë ndjerë përgjegjshmërinë pse fëmijët e tyre kanë ngelur të paidentifikuar dhe si qenie anonime në botën njerëzore, nëna që nuk njihen "de jure" dhe as nuk guxojnë të kërkojnë ndihmë nga organet

shtetërore përgjegjëse për këtë qëllim. Po vet punonjësit e shërbimeve të gjendjes civile, apo të shëndetit, apo të policisë, apo të shërbimeve sociale, po përfaqësuesit e komunitetit që me siguri marrin dijeni për persona të tillë pa identitet çfarë bëjnë, a vihen në lëvizje, a mobilizohen dhe a përpiqen të orientojnë këta persona të padukshëm si të veprojnë, a i asistojnë të mbledhin dokumentet që ju duhen si prova, a i rekomandojnë tek shërbimet e posaçme që ofrohen si nga shteti edhe nga organizatat joqeveritare, e shumë pyetje të tjera që normalisht lin-





din nga vet detyrimi që organet shtetërore kanë për regjistrimin civil të qytetarëve të vet.

S.M. është një nënë e re (ajo thotë jam 23- 24 vjeçe) me dy fëmijë dhe me një të tretë në pritje për të lindur, e paregjistruar vet në gjendjen civile, edhe fëmijët po ashtu. Shumë pyetjeve që ju drejtuan ajo nuk dinte t'i përgjigjej me saktësi: Dinte që prindërit e saj quheshin SK dhe VM. Dinte që ka lindur në maternitetin e Durrësit, por nuk dinte as datën as vitin. Dinte që në momentin e lindjes, babai ishte në burg dhe nëna në fillim ishte larguar për në Korçë bashkë me beben, pastaj kur i ati doli nga burgu

e kishte rrëmbyer nga e ëma dhe e kishte rritur së bashku me të afërmit e tij. SM nuk dinte se ku gjendej e ëma, as gjyshja nga nëna, persona të cilët ligji i autorizon për regjistrimin e lindjes.

Nga shumë kërkime që TLAS organizoi në funksion të mbledhjes së informacionit për SM, doli se në arkivin e maternitetit të Durrësit pasi u kontrolluan regjistrat e viteve 1990, 1991 dhe 1992 doli se SM, kishte lindur më 27.03. 1992. Nga Materniteti u mor një dublikatë e Certifikatës së Asistencës në Lindje e SM, provë shumë e rëndësishme për procedurën e regjistrimit me ruge administrative.

Nga shumë kërkime të tjera përmes të afërmeve doli se nëna e Stelës, VM , jetonte në Greqi. Ajo u kontaktua përmes telefonit dhe ju kërkua të vinte në Tiranë kundrejt pagesës së rugës nga ana e TLAS.

Nëna erdhi në Tiranë, ku organizuam takimin e saj me Stelën dhe me bashkëjetuesin e saj, babanë e tre fëmijëve. Nga VM mësuam

se ajo e kishte regjistrimin civil të saj në qytetin e Pogradecit kështu që edhe akti i lindjes do të mbahej ne këtë qytet. Nëna, Stela dhe babai i fëmijëve shkuan në Pogradec me shpenzimet të mbuluara nga TLAS. Më në fund u mbajt akti i lindjes së SM, dhe detyra e nënës së SM mbaroi aty, ajo u kthye në Greqi.

Për SM filloi një etapë e re shume e bukur nga çka ajo kishte ëndërruar, ajo aplikoi për kartë identiteti, ajo u pajis me certifikatë lindjeje, me certifikatë familjare të trungut

të nënës. Ajo shpalli martesën me qytetarin EK, nga Cërriku, Elbasan për të lidhur martesën. Ajo kishte të drejtë të tërhiqte nga materniteti më në fund dublikatën e certifikatës në lindje për dy fëmijët e saj, të datëlindjeve 14.03.2010 dhe 13.08.2012.

SM tani është një shtetase normale në vendin e vet, ajo mund të regjistrohet për punë, për strehim, për ndihmë ekonomike, për sigurime shëndetësore, për arsimimin e fëmijëve dhe të gëzojë të gjitha të drejtat e saj kushtetuese.





SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 1 / 2014

TLAS

